



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCËVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



DOGANA E KOSOVËS
CARINA KOSOVA- KOSOVO CUSTOMS

UDHËZUES

PËR

RREGULLAT E ORIGINËS

Prishtinë 20.09.2018

PËRBAJTJA

1. PARATHENJE.....	3
2. Ç'ËSHTË ORIGJINA?	3
3. Ç'ËSHTË ORIGJINA JO-PREFERENCIALE?.....	3
4. Ç'ËSHTË ORIGJINA PREFERENCIALE ?	4
5. A MUNDEN TË GJITHA PRODUKTET TË KENË TRETMAN FAVORIZUES NË PAJTIM ME ORIGJINËN PREFERENCIALE?	4
6. SI MUND TË INFORMOHEM NËSE PRODUKTI IM MUND TË KUALIFIKOHET PËR TRETMAN PREFERENCIAL?	5
7. KLASIFIKIMI I MALLRAVE	6
8. A KA KRITERE TJERA PËRPOS LISTËS SË OPERACIONEVE NË TË CILËT BAZOHET PËRCAKTIMI I ORIGJINËS SË MALLIT ?	7
9. Ç'ËSHTË KUMULIMI ?	8
10. Ç'ËSHTË KUMULIMI BILATERAL?	8
11. Ç'ËSHTË KUMULIMI DIAGONAL?	8
12. ÇKA NË TË VERTETË PARAQET KONVENTA PAN-EURO-MEDITERANE MBI RREGULLAT PREFERENCIALE TE ORIGJINES..9	
13. Ç'ËSHTË KUMULIMI PAN-EURO-MEDITERAN?	9
14. ÇKA NËNKUPTOJM ME TERMIN “VARIABËL GJEOMETRKE?.....	10
15. KU MUND TA GJËJË PROTOKOLIN E ORIGJINËS ME VENDIN ME TË CILIN JAM DUKE BËRË TREGTINË?.....	10
16. CILAT DOKUMENTE DËSHMOJNË ORIGJINËN E MALLIT?.....	11
17. ÇKA REALITET PARAQET EKSPORTUESI I APROVUAR?.....	12
18. A KA PËRJASHTIME NGA VËRTETIMI I ORIGJINËS?	14
19. KU MUND TË FURNIZOHET ME EKZEMPLARË TË CERTIFIKATËS SË ORIGJINËS dhe te regjistrohem ne SISTEMIN REX?.....	14
ANEKSI 1 – Certifikata e Origjinës EUR.1 (BE, CEFTA dhe Sistemi Autonom i Preferencave me Turqinë).....	16
ANEKSI 2 Certifikata e Origjinës “FORM A” ose GENERALIZED SYSTE OF PREFERENCES.....	17
AEKSI 3 Teksti i deklaratës së origjinës	18

1. PARATHENJE

Qëllimi i këtij doracakut është që të sigurojë informata për komunitetin e biznesit në lidhje me rregullat preferenciale të origjinës që përdoren aktualisht në tregtinë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe partnerëve tregtare të sajë (BE dhe CEFTA) në Marrëveshjet e tregtisë së lirë si dhe me partneret në Sistemin Gjeneral të preferencave (GSP).

Prandaj është e pashmangshme që përmbajtja e këtyre informatave të jetë e njohur mirë për shumë nga përdoruesit e këtij manuali, por që do të jetë krejtësisht e re për të tjerët.

Sidoqoftë, ne shpresojmë se do të jetë një dokument i dobishëm informativ në përgjithësi për këdo që e konsulton.

Informatori trajton çështjet themelore lidhur me origjinën dhe shpjegon dispozitat e protokolleve të origjinës.

2. Ç`ËSHTË ORIGJINA ?

Origjina e mallit ka të bëjë me “përcaktimin nacional” të tijë në tregun ekonomik ndërkombëtarë, në mënyrë që të përcaktohet:

- a) shkalla e detyrimit doganor,
- b) restriksionet e ndryshme
- c) kuotat,
- d) obligimet tjera për produktin e caktuar komfor origjinës së tijë.

Kjo do të thotë “zbatimi i politikave ekonomike tregtare” ndërlidhet me përcaktimin e origjinës së tijë dhe njëherit është e nevojshme dhe e domosdoshme tarifimi i drejt në TARIK.

Prandaj ekzistojnë dy lloje të origjinës së mallit:

- Origjina Jo-preferenciale dhe
- Origjina preferenciale.

3. Ç`ËSHTË ORIGJINA JO-PREFERENCIALE?

Origjina jo-preferenciale thjesht konfirmon origjinën nacionale të mallit dhe nuk konfirmon ndonjë përfitim nga kjo.

Origjina jo-preferenciale është edhe nga produktet tërësisht të përfituar në një vend (koncepti i produkteve tërësisht të përfituar është i dhënë në nenin 27 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë),

Pastaj kur dy ose më shumë vende janë të përfshira në përfitimin e një produkti, origjina i takon vendit ku është kryer përpunimi i fundit substancial i argumentuar.

Origjina jo-preferenciale përdoret për të zbatuar masat e politikës tregtare si p.sh.:

- 3.1 Trajtimin e kombit më të favorizuar,
- 3.2 Masat antidumping,
- 3.3 masat mbrojtëse të sigurisë
- 3.5 kuotat tarifore
- 3.6 prokurimit të qeverisë

3.7 statistikat e tregtisë

3.8 Origjina jo-preferenciale po ashtu mundë të përdoret për përcaktimin në kontekst të origjinës “shenja e origjinës” (siç është “made in” shenja) për mallrat.

4. Ç’ËSHTË ORIGJINA PREFERENCIALE?

Origjinën preferenciale e përfitojnë mallrat nga vendet e caktuara dhe sjell beneficion për mallin i cili është subjekt i tregtisë së jashtme preferenciale ndërmjet vendeve të cilat e kanë aranzhuar atë marrëveshje, këto përfitime shkojnë në drejtim të reduktimit të taksës së doganës në import ose në eliminimin e sajë, heqjen e restriksioneve kuantitative – kuotave, barrierave jo tarifore etj.

Prandaj produktet tërësisht të përfituara në vende gëzojnë nga statusi preferencial i origjinës dhe kanë përfitim nga ky status.

Po ashtu edhe tek produktet në të cilat është kryer një punim apo përpunim substancial (në harmoni me listën e operacioneve e cila është shtojcë integrale e marrëveshjes), do të përfitojnë nga statusi preferencial i origjinës.

5. A MUNDEN TË GJITHA PRODUKTET TË KENË TRETMAN FAVORIZUES NË PAJTIM ME ORIGJINËN PREFERENCIALE?

Teorikisht të gjitha produktet mundë të kenë tretman favorizues në pajtim me origjinën preferenciale.

Kurse në realitet vendet nuk i japin preference mallrave të cilat ata i konsiderojnë si të ndjeshme për ekonominë e tyre, për këtë arsye këto çështje janë tema diskutimi ndërmjet palëve në marrëveshje.

Në parimet e Marrëveshjes së Tregtisë së lirë CEFTA 2006 si dhe në Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit me BE (MSA), mallrat të caktuara janë të përjashtuara nga preferencat (disa produkte esenciale të cilat ata i konsiderojnë sensitive për ekonominë e tyre), apo është caktuar një periudhë kohore e zbritjes graduale e tarifës doganore mbi ato produkte, që pas kalimit të këtij afati kohor transitor këto produkte e gëzojnë këtë preferencë si dhe një grup i caktuar i mallrave të cilat me hyrjen në fuqi të marrëveshjes lirohen nga të gjitha obligimet doganore..

Prandaj është e një rëndësie të veçantë që palët në marrëveshje të harmonizojnë qëndrimet që malli konkret i cili është subjekt i tregtisë ndërmjet tyre të përfitojë nga këto beneficione.

6. SI MUNDË TË INFORMOHET NËSE PRODUKTI IM MUNDË TË KUALIFIKOHET PËR TRETMAN PREFERENCIAL?

Rregullat e zbatueshme të origjinës me qëllim që produktet të trajtohen me origjinë preferenciale, burojnë nga aplikimi i Shtojcës I dhe dispozitave përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale pan-Euro-Mesdhetare të origjinës - Konventa Rajonale dhe në pajtim me Udhëzimin administrativë Nr. 11/2009 I cili bën implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizës).

Shtojca I përcakton rregulla të përgjithshme për konceptin e produkteve të origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.

Shtojca II përcakton rregulla të veçanta të zbatueshme ndërmjet palëve të caktuara kontraktuese dhe që derivojnë nga dispozitat e parashikuara në shtojcën I.

Palët e mëposhtme janë kontraktuese në këtë Konventë:

- Bashkimi Europian;
- Shtetet e EFTA-s siç renditen në preambulë;
- Ishujt Faroje;
- Pjesëmarrësit në Procesin e Barcelonës, siç renditen në preambulë;
- Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, siç renditen në preambulë.

Në lidhje me Bashkimin Evropian, kjo Konventë zbatohet në territorin në të cilin është i zbatueshëm Traktati i Bashkimit Evropian, sipas përkufizimit në nenin 52 të atij traktati dhe nenin 355 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian.

Origjina preferenciale e mallrave munde te jete nga:

1. Mallrat tërësisht të përfituara

2. Mallrat te cilat i nënshtrohen një punimi apo përpunim i mjaftueshëm ne harmoni me Shtojcën I te KONVENTES RAJONALE mbi rregullat preferenciale pan-Euro-Mesdhetare të origjinës komform:

ANEKSI I - SHËNIMET HYRËSE PËR LISTËN E ANEKSIT II dhe
ANEKSI II - LISTA E PUNIMIT OSE E PËRPUNIMIT E KËRKUAR PËR T’U
KRYER ME MATERIALE JOORIGJINUESE ME QËLLIM PËRFTIMIN E
STATUSIT ORIGJINUES TË PRODUKTIT TË PRODHUAR, dhe

3. Kumulimi i origjinës (Neni 3 nga shtojca I e KONVENTES PEM).

Tek punimi apo përpunimi, para se të caktohet se në çfarë mase duhet të punohet apo përpunohet produkti, është e domosdoshme që të klasifikohet në sistemin e harmonizuar (HS) dhe se lista është e bazuar në klasifikimin e mallrave në Nomenklaturën e Harmonizuar HS (aplikimi i versionit HS - 2004).

Informata më detale se si interpretohet kjo Listë e punimit apo përpunimit mundë të gjenden tek SHTOJCA I - PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË ORIGJINËS” DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV (KONVENTA PEM)

7. KLASIFIKIMI I MALLRAVE

Klasifikimi tarifor është një fushë më vete, mjaftë komplekse e specializuar në kontekstin e doganës, në këtë rast është e domosdoshme të ceket kuptimi dhe rëndësia e sajë. Klasifikimi tarifor bazohet në sistemin i cili është hartuar në identifikimin e secilit produkt i cili është subjekt i tregtisë, si atyre produkteve të thjeshta natyrale, deri ato të cilat kanë një teknologji të lartë të përpunimit psh. pjesët e aparateve të ndryshme mjekësore etj.

Në kuadër të këtyre kërkesave secilit produkt i korrespondon numri tarifor.

Kodet tarifore janë të përfshira në tarifatat nacionale doganore të secilit vend. Në rastin e Marrëveshjes CEFTA 2006 ose në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, klasifikimit tarifor

është i bazuar në sistemin e harmonizuar të përshkrimit të mallit dhe sistemit të kodimit, i njohur si “SISTEMI I HARMONIZUAR” ose (HS).

Sistemi I Harmonizuar është ndarë në 97 “KAPITUJ” të cilët më pastaj janë të ndarë në “Krerë” tarifor prej 4 shifrave, e cila tarifë është komform me ANEKSIN II - LISTA E PUNIMIT OSE E PËRPUNIMIT E KËRKUAR PËR T’U KRYER ME MATERIALE JOORIGJINUESE ME QËLLIM PËRFTIMIN E STATUSIT ORIGJINUES TË PRODUKTIT TË PRODHUAR.

Bazuar në klasifikimin tarifor dhe në kombinim me origjinën, për çdo produkt është e mundur të përcaktohet niveli i shkallës së doganës dhe taksave tjera të cilat e ngarkojnë, preferencat, kuotat, ndalesat etj.

Në raste të caktuara klasifikimi tarifor dhe origjina jo-preferenciale janë të nevojshme të caktohen (psh. në rastet e masës anti-dumping).

Në kontekstin e origjinës preferenciale, është esenciale të dihet numri i saktë tarifor, për arsye se punimi apo përpunimi i cili është i nevojshëm me qëllim që produkti të fitoj statusin e origjinës po ashtu bazohet në Sistemin e Harmonizuar (HS), dmth. Në Listën e operacioneve e cila përcakton kriteret për përfitim të origjinës preferenciale të produkteve.

Për këtë arsye është e një rëndësie vitale klasifikimi i drejtë tarifor i produktit. Përndryshe Importuesit dhe Eksportuesit do të ballafaqohen me probleme dhe vështirësi.

Po ashtu vlen të theksohet se është obligim i Importuesit apo Eksportuesit që të sigurojnë një klasifikim të drejtë tarifor të mallit ashtu siç përcaktohet në harmoni me rregullat të cilat derivojnë nga TARIK-u.

Nëse nuk jeni të sigurtë në klasifikimin e drejtë të mallit tuaj atëherë preferohet që Importuesi apo Eksportuesi ta kontaktoj zyrën më të afërt doganore e cila do t’i afrojë ndihmë profesionale në lidhje me atë klasifikim. Po ashtu duhet pas parasysh që dogana për të ju dalë në ndihmë, duhet që ju të jeni në gjendje ta përshkruani në mënyrë shumë precize produktin tuaj, informatat e mjaftueshme në lidhje me materialet të cilat janë pjesë përbërëse e produktit, funksionin e tij si dhe nëse është e nevojshme edhe literaturën që e ilustron produktin konkret, fotot etj.

8. A KA KRITERE TJERA PËRPOS LISTËS SË OPERACIONEVE NË TË CILËT BAZOHET PËRCAKTIMI I ORIGJINËS SË MALLIT ?

Përveç kërkesave të përcaktuara në punimin apo përpunimin e mjaftueshëm – Lista e Operacioneve, ekzistojnë definicione precize në lidhje me nocionin “nacional” në kontekstin e origjinës. Kjo është e një rëndësie të veçantë kur kemi të bëjmë me përcaktimin e origjinës për peshkun dhe produkteve të peshkut.

9. Ç’ËSHTË KUMULIMI ?

SHTOJCA I - PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË ORIGJINËS” DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV (KONVENTA PEM), paraqet Listën e përpunimit e cila e përcakton punimin apo përpunimin e nevojshëm që produkti duhet ti

nënshtrohet në mënyrë që ai të përfitoj beneficionet që burojnë nga statusi i origjinës preferenciale.

Mirëpo në prodhimtarinë moderne është e zakonshme që për përfitimin e një produkti janë të involvuar dy ose më shumë prodhues nga vendet e ndryshme. Në raste kur dy ose më shumë vende implementojnë rregulla identike të origjinës dhe kanë ne zbatim Marrëveshje të Tregtisë së lirë ndërmjet vete, atëherë ato mundë ta shfrytëzojnë nocionin e **KUMULIMIN TE ORIGJINËS** duke u bazuar ne:

- njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të zbatuar kumulimin e që janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian (seria C) dhe
- palët kontraktuese janë palë në marrëveshjet përkatëse, sipas procedurave të tyre.
- Kumulimi i parashikuar zbatohet nga data e treguar në njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian (seria C).

Prandaj kumulimi I origjinës është nocion I cili përdoret në marrëveshjet për tregtinë e lirë, i cili para së gjithash i jep hapësirë definicionit mbi produktet origjinuese.

Në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA 2006 ose në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), kumulimi nënkupton atë se kur produktet e caktuara kanë fituar statusin e origjinës në një nga vendet partnere, mundë të përdoren si produkte origjinuese në vendin tjetër partnerë, pa ndonjë ndikim negative në statusin preferencial të produktit final. Me fjalë të tjera kjo do të thotë, se me rastin e verifikimit të origjinës të këtij produkti final këto komponentë të përdorura me rastin e përpunimit trajtohen si materiale origjinuese, njëjtë si çdo komponent tjetër me origjinë vendore.

Me rastin e kumulimit, punimi apo përpunimi i kryer në cilin do vend partnerë në “produktin origjinues” nuk do të thotë nënshttrimit të rregullave “punim apo përpunim i mjaftueshëm” nga Lista e Operacioneve që produkti final të fitoj statusin e mallit me origjinë nga vendi në të cilin është kryer ky përpunim, por ky punim apo përpunim duhet ti kaloj “operacionet minimale” të cilat janë të renditura në Neni 6 - Punim ose përpunim i pamjaftueshëm ne KONVENTEN PEM.

10. Ç’ËSHTË KUMULIMI BILATERAL?

Kumulimi Bilateral i Origjinës aplikohet ndërmjet dy vendeve partnere. Kjo do të thotë që materialet origjinuese në një nga palët kontraktuese lejohet të përdoren në procesin e përpunimit në palën tjetër kontraktuese pa I u nënshtuar rregullave “punim apo përpunim i mjaftueshëm” të produktit final.

Ose shih diagramin e më poshtëm:


DIAGRAMI 1



11. ÇËSHTË KUMULIMI DIAGONAL

Kumulimi diagonal aplikohet ne tregtinë preferenciale ndërmjet tri apo më shumë vendeve. Nëse vendet A, B dhe C kanë ndërmjet veti Marrëveshje të tregtisë së lirë (secila me secilën) ku në këto marrëveshje zbatojnë rregulla identike të origjinës të cilat e përcaktojnë shkallën e punimit apo përpunimit të materialit jo-origjinues, psh. Vendi A mundet ta zbatoj kumulimin diagonal të origjinës në tregtinë me dy vendet tjera partnere B dhe C në qoftë se marrëveshjet e tilla e parashohin këtë mundësi

DIAGRAMI 2



Nga diagrami është shumë e qartë se te tri këto vende janë në tregti të përbashkët dhe janë të lidhura me Marrëveshje. Secili vend duhet të ketë rregulla identike të origjinës me dy të tjerat. Nuk është e mjaftueshme që vetëm vendi A të zbatojë rregulla identike të origjinës me dy vendet tjera, por edhe vendet B dhe C duhet të zbatojnë rregullat e njëjta.

Një vend mundë ta zbatoj kumulimin diagonal të origjinës, vetëm me ato vende me të cilat e ka një Protokoll të origjinës I cili e parasheh atë lloj të kumulimit dhe përmban rregulla identike të origjinës.

Po ashtu, kumulimi diagonal I origjinës mundë të aplikohet edhe në rastet kur tri apo më shumë vende kane marrëveshje te tregtisë se lire, dhe se në vend se të kenë më shumë marrëveshje bilaterale, ato munde ta kanë një marrëveshje Multilaterale të tregtisë së lirë e cila e parasheh një mundësi të tillë te Kumulimit, shembull konkret Marrëveshja e tregtisë se lire CEFTA dhe MSA (bazuar ne rregullat identike te përcaktuara ne KNVENTEN PEM)

12. ÇKA NË TË VERTET PARAQET KONVENTA PAN-EURO-MEDITERANE MBI RREGULLAT PREFERENCIALE TE ORIGJINES?

Është Marrëveshje ndërkombëtare (Instrument legal) vendos një pakete të vetme të rregullave të origjinës.

Zëvendëson rregullat e origjinës në të gjitha Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) ndërmjet Palëve Kontraktuese në Konventën PEM me një instrument të vetëm legal mbi rregullat e origjinës

Krijon një zone të madhe të kumulimit diagonal (bashkimi aktual i PEM kumulimit dhe SAP Kumulimit)

Është e botuar në Fletoren Zyrtare L54 e 2013/02/26 të BE

Vendos rregulla identike për të gjitha palët (kushte te barabarta për aplikimin e kumulimit diagonal), siguron zgjerimin e zonës për kumulim diagonal të origjinës (në mes vendeve të EFTA dhe vendeve në SAP; si dhe në mes vendeve SAP dhe MED)

Mund të menaxhohet/ndryshohet më lehtë – nuk ka nevojë të ndryshohen mese 60 protokolle individuale dhe bën të mundur ndryshimin më të lehtë të rregullave të origjinës në funksion të thjeshtimit të tyre dhe përshtatjen ndaj realitetit të ri ekonomik, duke mundësuar zgjerim më lehtë duke përfshirë Partnerë të rinj (sa më shumë partnerë aq më shumë mundësi kumulimit në tregtinë e tyre)

13. Ç'ËSHTË KUMULIMI PAN-EURO-MEDITERAN?

Kumulimi Pan-Euro-Mediterran është një term i cili përdoret për të përshkruar Sistemin diagonal të kumulimit ndërmjet vendeve të Bashkimit Evropian dhe një numër vendesh të Evropës dhe të Mediteranit.

Konventa PEM mundëson bashkimin aktual të PEM Kumulimit me atë të SAP (SAP-partneret në procesin e stabilizimit asociimit) Kumulimit.

Shtrohet pyetja logjike, nga cilat pale në Konvente aplikohet PEM dhe SAP Kumulimi? PEM Kumulimi në situatën aktuale aplikohet nga 16 partner dhe atë:

BE (Austria, Belgjika, Bullgaria, Qipro, Republika Qeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Holanda, Irlanda, Italia, Latvia, Lituania, Luxemburgu, Kroacia, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Spanja, Sllovakia, Sllovenia, Suedia dhe Britania e Madhe), TR, Ishujt Faroje, EFTA Shtetet (Islanda, Liechtenstein, Norvegjia, Zvicra), dhe shtetet e Mediteranit (Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordani, Libani, Maroku, Tunizi, Autoriteti Palestinez), ndërsa

SAP Kumulimi aplikohet nga vendet e Ballkanit perëndimor (6 partner - partneret në procesin e stabilizimit asociimit) me : BE dhe TR,

14. ÇKA NËNKUPTOJM ME TERMIN “VARIABËL GJEOMETRKE?”

Këtë term do ta analizojmë në Kontekstin e Marrëveshjes CEFTA 2006 në mënyrë që lexuesi ynë të jetë më afër problemit i cili e shtjellon këtë nocion, kjo dmth. që kumulimi diagonal me vendet e EFTA (Islandën, Norvegjinë, Zvicrën, Lihtestein) dhe Turqinë, është e mundur vetëm ndërmjet vendeve anëtare të CEFTA 2006 të cilat e kanë të nënshkruar një protokoll të tregtisë së lire me vendet e sipërpërmendura, ndërsa ky lloj kumulimi nuk vlen për vendet tjera psh. Kosovën.

Me fjalë të tjera, në varësi nga kjo, vendet në tregtinë e tyre në mesë veti mundë ta aplikojn këtë kumulim, bazuar në marrëveshjet që posedon secili vend me tjetrin duke iu referuar Matricës e cila publikohet ne Gazetën Zyrtare të Bashkimit European (seria C) publikimi i fundit është bere me date **14.09.2018/(2018/C 325/06)** - Njoftimi i Komisionit Evropian në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale pan-Euro-Mediterrane të origjinës ose protokollet mbi rregullat e origjinës që parashikojnë kumulimin diagonal midis Palëve Kontraktuese të kësaj Konvente.

15. KU MUND TA GJEJ PROTOKOLIN E ORIGJINËS ME VENDIN ME TË CILIN JAM DUKE BËRË TRGTINË?

Zbatimi I drejtë I Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë varet nga vendi se ku malli eksportohet, ose nga vendi i cili importohet.

Protokollet e Origjinës janë pjesë përbërëse e Marrëveshjeve Ndërkombëtare të tregtisë së lirë të cilat i implementon vendi i caktuar.

Tregtinë e jashtme te Republikës se Kosovës në momentin aktual e karakterizojnë:

1. Dy Marrëveshje te Tregtisë së Lirë - CEFTA 2006 dhe MSA,
2. Sistemi Autonom i preferencave me Turqinë (H.S. 25-97)
3. Sistemi Gjeneral preferencave (GSP) – Zvicra, Norvegjia, SHBA, Japonia

Sistemet preferenciale janë beneficione qe zakonisht i japin vendet e zhvilluara ekonomikisht, vendeve në zhvillim apo atyre të pa zhvilluara në atë mënyrë që te hapin tregun e tyre për produktet origjinuese nga këto vende duke i eliminuar barrierat tarifore për produktet të cilat importohen nga këto vende, me fjalë tjera këto njihen si Grande të cilat u japin këtyre vendeve, ose SISTEMI AUTONOM I PREFERENCAVE i cili zbatohet nga ana e Turqise.

Kjo nuk ka të bëjë me nënshkrimin e ndonjë Protokolli të origjinës ose MTL-je por thjesht është një bonus për vendet e pa zhvilluara ekonomikisht.

Këto informata lehte munde te merren nga faqja web faqja e Doganës se Kosovës <http://dogana.rks-gov.net/>

16. CILAT DOKUMENTE DËSHMIOJN ORIGJINËN E MALLIT?

1. SHTOJCA I - PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE TË ORIGJINËS” DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV (KONVENTA PEM), parasheh se produktet origjinuese në një palë kontraktuese gjatë importimit në palë të tjera kontraktuese, do të përfitojnë nga dispozitat e marrëveshjeve përkatëse me paraqitjen e një prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:

- a) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një formë e së cilës tregohet në aneksin III a;
- b) një deklaratë që këtu quhet “deklarata e origjinës”, të dhënë nga eksportues në një faturë, një notë dërguese apo një dokument tjetër tregtar, ku të përshkruhen produktet në detaje

të mjaftueshme për t'u identifikuar; tekstet e deklaratave të origjinës shfaqen në anekset IV a dhe b.

Një deklaratë origjinë mund të përgatitet:

- a) nga një eksportues i aprovuar (autorizuar nga Dogana – Komfor Udhëzuesit të brendshëm Nr. 431/2017 – Për procedurën e lejimit të autorizimit lidhur me eksportuesin e aprovuar), ose
- b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6.000,00€.

2. Ndërsa Sistemi Autonom i Preferencave me Turqinë parasheh se produktet origjinuese nga Kosova do të përfitojnë nga ky sistem me paraqitjen e një prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:

- a) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një formë e së cilës tregohet në Aneksin 1 të këtij udhëzuesi, dhe
- b) një deklaratë që këtu quhet “deklarata e origjinës”, të dhënë nga eksportues në një faturë, një notë dërguese apo një dokument tjetër tregtar, ku të përshkruhen produktet në detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar; tekstet e deklaratave të origjinës shfaqen në Aneksin 3 të këtij udhëzuesi.

3. Sistemi Gjeneral preferencave (GSP) – Zvicra, Norvegjia, SHBA, Japonia Ne harmoni me Nenin 31(a) paragrafi 1 të rregullores mbi rregullat e origjinës lidhur me kërkesat të cilat burojnë nga shema Zvicerane dhe Norvegjeze e Sistemit Gjeneral të Preferencave (GSP) për trajtim preferencial vërtetimi i origjinës i përdorur certifikata FORM A zëvendësohet nga data 1 Korrik 2018, me sistemin e regjistrimit elektronik REX. Produktet me origjinë preferenciale nga Kosova, vlera totale e të cilave kalon 10`300 CHF (dhjetë mijë e treqind frangave Zvicerane) ose 100`000 KON (njëqind mijë koronave Norvegjeze) do të trajtohen me tretman preferencial tarifor në këto dy vende, vetëm në rastet kur eksportuesi është i regjistruar në sistemin elektronik REX dhe posedon Nr. e regjistrimit REX të deklaruar në faturën komerciale shitëse, një formë e së cilës pasqyrohet si më poshtë psh. :

The exporter " X..Y...Z..." SH.P.K., Rr. H Prishtina No. 75, 1000 Prishtine, Kosovo (Number of registered exporter: XKREX601.....) of the products covered by this document declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of Kosovo preferential origin according to the rules of origin of the Generalized System of Preferences of Switzerland and that the origin criterion met is "W"9403.

Per pjesën e mbetur të vendeve Sistemi Gjeneral i Preferencave (GSP) me SHBA, Japoninë, Islandën parasheh se produktet origjinuese nga Kosova do të përfitojnë nga ky sistem me paraqitjen e një prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:

- a) një certifikatë qarkullimi mallrash FORM A, një formë e së cilës tregohet në aneksin 2 të këtij udhëzuesi;
- b) një deklaratë që këtu quhet “deklarata e origjinës”, të dhënë nga eksportues në një faturë, një notë dërguese apo një dokument tjetër tregtar, ku të përshkruhen produktet në detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar; tekstet e deklaratave të origjinës shfaqen në Aneksin 3 të këtij udhëzuesi, vlera totale e të cilave nuk kalon 6,000.00€, kjo deklaratë vlen edhe për Exportet edhe në shtetin zviceran dhe Norvegjez me kusht që vlerat totale e

produkteve nuk kalon 10`300 CHF (dhjetëmijë e treqind frangave Zvicerane) ose 100`000 KON (njëqindmijë koronave Norvegjeze)

17. ÇKA NE REALITET PARAQET EKSPORTUESI I APROVUAR?

"Eksportues i Aprovuar" do të thotë një eksportues i cili është i regjistruar në autoritetin kompetent të vendit përfitues në fjalë (doganën e Kosovës) i cili jep deklaratë mbi origjinën e mallit me qëllim të eksportit në vendet favorizuese në bazë të skemës;

Kriteret për përfitimin e statusit të eksportuesit të aprovuar:

- a) Të ketë eksportuar mallra me origjinë preferenciale, me provë të origjinës për një periudhë prej minimumi dy vjet para datës së kërkesës;
- b) Të mos ketë pasur asnjë rast të kontestuar për provat e origjinës të përdorura prej tij në eksport;
- c) Të ketë një frekuencë prej minimumi 1 ngarkese për eksport në muaj ose 12 eksporte në vit.
- d) Të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar statusin e origjinës së mallrave të cilat do të prodhoj/eksportoja)
- e) Kompania aplikuese duhet të lejojë inspektimin e llogarive financiare si dhe çdo kontroll dokumentar dhe fizik që konsiderohet i nevojshëm nga autoritet doganore lidhur me provat e origjinës.
- f) Në momentin e aplikimit për marrjen e statusit të Eksportuesit të Aprovuar të mos ketë asnjë detyrim doganor të papaguar.
- g) Kompania të ketë të punësuar të paktën një person përgjegjës që ka njohuri mbi rregullat e origjinës, sepse vetëm atëherë garantohen detyrimet e eksportuesit.

Vlefshmëria e statusit të eksportuesit të Aprovuar

- Autorizimi i eksportuesit të aprovuar lidhur me deklarin e origjinës referenciale është i vlefshëm për të gjitha eksportet në vendet apo grupimet e vendeve me të cilat zbatohen marrëveshjet e tregtisë së lirë
- Në rastet e hyrjes në fuqi të një marrëveshjeje të re të tregtisë së lirë, Eksportuesi i Aprovuar me qëllim përfitimin nga statusi i ri preferencial në vendin e ri partner, duhet të paraqesë një kërkesë pranë Doganës së Kosovës për përfshirjen e këtij vendi apo grupi vendesh në autorizim.
- Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar

Detyrimet e eksportuesit të aprovuar

- Të sigurojë përdorimin e këtij Statusi vetëm për mallrat me Origjinë Preferenciale.
- Të sigurojë që Deklarata-Faturë të jetë e plotë dhe e saktë sipas kushteve të Marrëveshjeve të Tregtisë se Lirë në varësi të vendit ku do të kryhet eksporti.
- Në Deklaratë-Faturë duhet të shënohet numri i autorizimit. Deklarata-Faturë do të lëshohet nga eksportuesi nëpërmjet shtypjes, stampimit apo printimit në

faturë, në fletë dërgesë apo në një dokument tjetër tregtar, ku të përshkruhen produktet në detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar (teksti i deklaratës së origjinës munde te gjendet ne Aneksin 3 te këtij udhëzuesi)

- Të ruajë në mënyrë të rregullt të dhënat e Deklaratave Faturë dhe ti ruajë ato për së paku 3 vjet nga data e lëshimit së bashku me dokumentet që konfirmojnë origjinën e secilës deklaratë.

- Të lejojë autoritetet doganore të kryejnë inspektim të llogarive financiare dhe tu sigurojë atyre kur është e nevojshme prova shtesë.

- Të njoftojë menjëherë Doganën e Kosovës për ndryshime në proceset e prodhimit, lëndës së parë të importuar apo kushteve të Rregullave të Origjinës;

- Në fund të çdo viti (nga data e aprovimit), duhet të paraqesë pranë Sektorit të Origjinës një raport informues lidhur me Deklaratat-Faturë të lëshuara për mallrat e eksportuara.

- Të sigurojë ndalimin e rimbursimit apo përjashtimin nga detyrimet doganore të materialeve jo origjinuese të përdorura në prodhimin e produktit final.

Të sigurojë që transporti i mallrave me origjinë preferenciale të jetë i tillë, që të plotësojë kërkesat e transportit të drejtpërdrejtë.

- Të mbajë përgjegjësi të plotë në lidhje me deklarimin e gabuar të origjinës, aplikimin jo të drejtë të rregullave të origjinës apo keqpërdorimin e autorizimit

18. A KA PËRJASHTIME NGA VËRTETIMI I ORIGJINËS?

Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privat tek personat privat ose janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve do të pranohen si produkte me origjinë pa kërkuar paraqitjen e vërtetimit të origjinës, me kusht që:

- # Produktet e tilla nuk janë importuar për qëllime të tregtisë,
- # Janë të deklaruara si produkte me origjinë,
- # Nuk ekziston ndonjë dyshim në deklarim të palës e cila e bartë ose e pranon këtë mall.

Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të kaloj 500€ në rastin e pakove të vogla ose 1 200€ në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve.

Kur dogana ka një dyshim të bazuar në vlerën dhe origjinën e mallit të deklaruar, atëherë organet doganore mundën të kërkojnë dëshminë mbi origjinën e këtij produkti me qëllim të trajtimit preferencial. Përndryshe nëse nuk paraqitet ajo dëshmi atëherë ai mall do të trajtohet në procedurë të rregullt doganore.

19. KU MUND TË FURNIZOHEN ME EKZEMPLARË TË CERTIFIKATËS SË ORIGJINËS dhe te regjistrohem ne SISTEMIN REX?

Dogana e Kosovës është autoriteti kompetent për lëshimin e Certifikatës së origjinës EUR.1 bazuar në Nenin 48 të Udhëzimit Administrative Nr.11/2009 i cili bën implementimin e

Kodit të Doganave dhe Akcizës në Kosovë, si dhe regjistron kompanitë eksportuese ne Sistemin e regjistrimit REX.

Dogana e Kosovës në momentin aktual bën lëshimin e këtyre formave të ekzemplarëve të certifikatave të origjinës:

1. Certifikata e Origjinës EUR.1 e cila përdoret për të eksportuar mallrat nga vendi ynë në: Vendet e CEFTA, Bashkimin Evropian dhe në Turqi si dhe është kompatible me aneksin 21 të Kodit Doganor Evropian (Rr. 2454/93) (Aneksi 1), gjegjesisht një formë e së cilës tregohet në aneksin III a te KONVENTES PEM
2. Certifikata e Origjinës "FORM A" ose (GENERALIZED SYSTEM OF PREFERENCES) (Aneksi 2)

Të gjitha këto forma të sipërpërmendura do ti gjeni të bashkangjitura në anekse të këtij udhëzuesi.

Certifikata e origjinës EUR.1 lëshohet vetëm me kërkesë me shkrim të eksportuesit apo nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Kjo kërkesë mbahet së paku për tri vite nga Dogana e Kosovës si dëshmi me rastin e ndonjë e kontesti eventual.

Eksportuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të paraqesin bashkë me kërkesën e tyre gjithë dokumentacionin përcjellës, me të cilin dëshmohet se produkti i cili është subjekt i eksportit kualifikohet për të lëshuar certifikatën e origjinës EUR.1

Eksportuesi merr për obligim të paraqesë me kërkesë të Doganës së Kosovës ndonjë dëshmi shtesë, të cilat nevojiten për qëllim që të konstatojnë statusin e origjinës për produktet, të cilat kanë të drejtë në trajtim preferencial dhe duhet të pajtohet për ndonjë inspektim të llogarisë (librave) të tij, si dhe ndonjë kontroll nga dogana e Kosovës mbi rrethanat në të cilat është fituar produkti.

Veprimet e mësipërme merren edhe me rastin e kërkesës së ndonjë vendi i cili produkteve me origjinë nga vendi u jep trajtim preferencial qofshin ato vende me të cilat kemi të nënshkruar ndonjë marrëveshje të tregtisë së lirë, apo ato të cilat e zbatojnë Sistemin Autonom të Preferencave për vendin tonë.

Prandaj nga kjo që u cek më lart eksportuesit kosovar, produktet e tyre origjinuese mundë ti eksportojnë, duke përfituar nga trajtimi preferencial i origjinës në:

- a. vendet e Bashkimit Evropian (28 vende)
- b. vendet në Marrëveshjen për Tregtinë e Lirë CEFTA 2006
- c. vendet EFTA
- d. Turqi
- e. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), dhe
- f. Japoni

ANEKSI 1 – Certifikata e Origjinës EUR.1 (BE, CEFTA dhe Sistemi Autonom i Preferencave me Turqinë)

DE LA RUE INTERNATIONAL
No. 06.3.1.012.2010

MOVEMENT CERTIFICATE

1. Exporter (Name, full address, country)		EUR.1 No A 000778	
		See notes overleaf before completing this form	
3. Consignee (Name, full address, country) (Optional)		2. Certificate used in preferential trade between	
		<p>_____</p> <p>and</p> <p>_____</p> <p>(insert appropriate countries, groups of countries or territories)</p>	
		4. Country, group of countries or territory in which the products are considered as originating	5. Country, group of countries or territory of destination
6. Transport details (Optional)		7. Remarks	
8. Item number; Marks and numbers; Number and kind of packages (1); Description of goods		9. Gross mass (kg) or other measure (litres, m ³ , etc)	10. Invoices (Optional)
11. CUSTOMS ENDORSEMENT Declaration certified. Export document (2): Form.....No..... Customs office: Issuing country or territory:.....		12. DECLARATION BY THE EXPORTER I, the undersigned, declare that the goods described above meet the conditions required for the issue of this certificate. Place and date:	

(1) 1/2010
401/112
000000/11
01/00
001100/10
49/001/10
0000/11
0000/10
0000/10

(2) Complete
only where
the importer
knows of
the export
ing country

ANEKSI 2 - Certifikata FORM A (GSP)

1. Goods consigned from (Exporter's business name, address, country)		Reference No A 000146			
2. Goods consigned to (Consignee's name, address, country)		GENERALIZED SYSTEM OF PREFERENCES CERTIFICATE OF ORIGIN (Combined declaration and certificate) FORM A			
3. Means of transport and route (as far as known)		Issued in _____ (country) See Notes overleaf			
4. For official use					
5. Item number	6. Marks and numbers of packages	7. Number and kind of packages: description of goods	8. Origin criterion (see Notes overleaf)	9. Gross weight or other quantity	10. Number and date of invoices
11. Certification It is hereby certified, on the basis of control carried out, that the declaration by the exporter is correct. _____ <small>Place and date, signature and stamp of certifying authority</small>		12. Declaration by the exporter The undersigned hereby declares that the above details and statements are correct; that all the goods were produced in _____ <small>(country)</small> and that they comply with the origin requirements specified for those goods in the Generalized System Preferences for goods exported to _____ <small>(importing country)</small> _____ <small>Place and date, signature and stamp of authorized signatory</small>			

AEKSI 3

Teksti i deklaratës së origjinës do të jetë:

- a) në gjuhën shqipe

Eksportuesi i produkteve të mbuluara nga ky dokument (autorizimi doganor nr. XK/0000/2017) deklaron që, përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë preferenciale të Kosovës.

.....
(Vendi dhe data)

.....
(nënshkrimi, i shoqëruar me emrin dhe mbiemrin
e personit i cili nënshkruan deklaratën faturë
të shkruar me germa të qarta)

- b) në gjuhën angleze:

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No. XK/0000/2017) declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of Kosovo preferential origin.

.....
(Place and date)

.....
(Signature of the exporter, in addition the name of the person signing the declaration has to be indicated in clear script)